



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 948 /2021

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja e dhjetë -X- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 09.11.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Edon Curri (Drejtor i Administratës), Ilir Kaloshi (Përfaqësues nga kompania NPL "Pastrimi"), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon një anëtarë i Kuvendit të Komunës z.Mehmet Ballazhi.

Kryesuesi thekson:- para se me procedura me pikat e rendit të punës kërkesë kam nga shefat e grupeve parlamentare pasi që kjo mbledhje është e fundit kërkojnë që tu epet fjala. Për fillim fjalën e ka kërkuar z.Mefail Suma dhe pastaj do të vazhdojnë me radhë.

Mefail Suma thekson:- në këtë kuvend më ka pëlqyer pjesëmarrja e anëtarëve të kuvendit të komunës dhe jam i kënaqur me opozitën me të cilën kam kaluar mirë por edhe me ju të tjerët të cilët keni qenë në pozitë kam kaluar mirë. Më ka pëlqyer organizimi i udhëheqjes së mbledhjeve të kuvendit të komunës nga kryesuesi i kuvendit dhe kemi kaluar mirë, u jam mirënjohës të gjithëve. Për mu është mandati i fundit si anëtarë i asamblesë komunale, ju falënderoj gjithëve dhe ju uroj sukses juve që jeni zgjedhur në asamblenë komunale.

Sabedin Hasallari thekson:- ju falënderoj të gjithëve këshilltarët komunal, po ashtu falënderoj kryetarin e komunës i cili ka qenë deri tash, falënderoj ekzekutivin e komunës me të cilët kemi pasur një bashkëpunim. Këshilltarët e rinj të cilët janë zgjedhur ju urojë suksese dhe kryetarit të ri i dëshirojë suksese.

Nora Xhoni thekson:- të nderuar kolegë ju në largim dhe ju që keni fituar ulëse në kuvendin e komunës, të nderuar drejtor ju falënderojë për punën të cilën e keni bërë, me të cilët kemi pasur bashkëpunim të mirë dhe kemi qenë të kënaqur me punën të cilën e keni bërë. Partisë demokratike i urojë fitoren dhe i dëshirojë suksese në të ardhmen.

Teuta Shkreta thekson:- edhe unë jam ndarë e kënaqur me punët të cilat janë bërë dhe ju falënderoj të gjithëve në emrin tim personale dhe në emër të Lëvizjes Vetëvendosje. Kuvendit në ardhje i dëshirojë suksese, po ashtu i dëshirojë suksese edhe partisë fituese.

Sead Vila thekson:- falënderojë kryesuesin e kuvendit të komunës dhe kolegët për mirëkuptimin, drejtorët dhe drejtoreshat për bashkëpunimin të cilin e kemi pasur. Gjithmonë qëllimi ka qenë që t'i diskutojmë dhe t'i zgjedhim alternativat më të mira dhe në shumë aspekte jam mundur me i arritur ata qëllime. Këshilltarët të cilët kanë fituar në legjislaturë të re ju urojë suksese. Partisë demokratike i urojë fitoren. Kryetarit në shkuarje dhe kryetarit në ardhje i urojë suksese dhe besoj që do të kontribuojnë për interesa të qytetarëve.

Florim Shkreta thekson:- falënderoj këshilltarët komunal që për mu ishin më të mirët. Falënderoj kryesuesin e kuvendit të komunës, ekzekutivin e komunës dhe kryetarin e komunës. Partisë fituese i urojë suksese dhe ju falënderoj gjithëve.

Kryesuesi thekson:- ju falënderojë të gjithëve për diskutimet të cilat i parashtruar dhe vazhdojmë me rendin e punës të paraparës sipas agjendës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021.
4. Vendim mbi caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2022.
5. Plani i biznesit i N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2022.
6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
7. Raporti mbi suksesin e arritur për përfundimin e vitit shkollor 2020/2021.
8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021 i N.P.L Pastrimi sh.a.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës kemi edhe materiale shtesë , kërkesa e z.Bedri Bushi për ndërrim destinim të pronës. Propozim vendimi për çështjen e llaptopëve të cilën e kam diskutuar me shefat e grupeve parlamentare. Kemi pranuar edhe një kërkesë për lirim nga pagesat për fëmijët me sindrom.

Zaim Bela thekson:-kam pranuar kërkesën e z.Bedri Bushi për ndërrim destinim të pronës në lagjen e ujit të thartë . Materialin e keni para vetës dhe kërkoj që kjo pikë të procedohet më tutje.

Edon Curri thekson:- me ligj të ri llaptopoët për një vit amortizohen 25 % e që për katër vite i bien që amortizohen totalishtë dhe për atë është vendosur që llaptopët me i mbajtur në pronësi

Menduh Vlashi thekson:- sa i përket kësaj pike kërkesa kemi pasur por nuk jemi konsultuar mirë me udhëzimet administrative dhe me legjislacionin në fuqi dhe kërkoj që kjo të mbetet legjislaturës së ardhme në mënyrë që mos me pasur ndonjë problem me legjislacionin

Medina Imishti thekson:- këtë çështje e kemi diskutuar dhe propozimi jonë ishte që të lirohen nga pagesa fëmijët të cilët janë me aftësi të kufizuara.

Kryesuesi thekson:- unë mendoj që kjo çështje t'i mbetet ekzekutivit dhe legjislativit të ri i cili do të vjen për shkak se ndoshta mund të kemi ndonjë problem me ligjshmërinë. Kërkesën për ndërrim destinim dhe Propozim Vendim për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit i hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës, rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.
3. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021.
4. Vendim mbi caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2022.
5. Plani i biznesit i N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2022.
6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.
7. Raporti mbi suksesin e arritur për përfundimin e vitit shkollor 2020/2021.
8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021 i N.P.L Pastrimi sh.a.
9. Kërkesa e z.Bedri Bushi për ndërrim destinim.
10. Propozim Vendim për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit.
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë rreth gjendjes së koronavirusit në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Medina Imishti thekson:- deri më tani janë kryer 2002 teste serologjike. Është bërë vaksinimi i të gjitha grupmohave dhe gjitha punët të cilat janë kryer në QKMF janë bërë në bazë të rekomandimeve të cilat i kemi marr nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga instituti kombëtarë i shëndetit publik . Nga data 04.11.2021 nga Ministria jemi njoftuar se qytetarët mund të vaksinohen pa termine dhe është lejuar vaksinimi edhe për fëmijët nga mosha 12 vjeçare me pëlqim të prindit apo kujdestarit ligjorë. Në totale kemi dhënë 7835 vaksina, 4228 qytetarë me një dozë ndërsa 3607 janë vaksinuar me dy doza të vaksinimit. Përveç vaksinimit kovid 19 ka filluar edhe vaksinimi kundër gripit sezonal dhe nga Ministria jemi furnizuar me 1000 doza të vaksinimit me të cilat rekomandohen të vaksinohen qytetarët të cilët janë mbi moshën 65 vjet .

Sabedin Hasallari thekson:- sa persona janë për momentin në komunën tonë me kovid 19. Për gripin sezonal a është rregull që vetëm personat të cilat janë 65 vjet dhe mbi.

Medina Imishti thekson:- aktualisht nuk kemi asnjë rast pozitiv. Sa i përket vaksinimit sezonalë duhet të vaksinohen personat të cilët janë në moshën 65 vjeçare dhe kategoritë e tjera të cilët janë me sëmundje kronike dhe me rekomandim të mjekut mund të vaksinohen edhe mosha të tjera

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës.

3. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021.

Kryesuesi thekson:- kërkesë kam pasur nga shefat e grupeve parlamentare për çështjen e borgjeve, nëse ke ndonjë informacion është mirë me na dhënë sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- në kategorinë paga dhe shtesa shpenzimi është në shumë prej 1,197,301.43 € apo 72.45 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 223,744.83 € apo 63.35 %, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 40,135.78 € apo 59.90 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 60,255.00 € apo 75.05 %, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 185,648.50 € apo 34.79 % dhe në rezervat 0.00 €. Totali i shpenzimit për periudhën Janar - Shtator të vitit 2021 është në shumë prej 1,707,085.54 € apo 63.54 %. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 253,868.52 € të hyra vetanake për periudhën Janar- Shtator 2021 apo 87.96% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje më shumë për 74,221.86 € apo 41.32%. Sa i përket borgjeve kemi 644000 € mjete të pa shpenzuara, prej tyre 180 000 janë mjete të zotuar , 463483 € me të cilët do të kryhen pagesat e muajit nëntor dhe pastaj të dhjetorit dhe një pjesë ndoshta do të mbesin suficitë në paga por kemi bërë kërkesë në ministri të financave me na lejuar për pagesën e shujtave të arsimtarëve që e kemi aktgjykimin e gjykatës që mos me na shkuar mjetet financiare në suficitë. Në kategorinë mallra dhe shërbime për momentin janë 50000€ të procesuara por ende nuk janë proceduar për pagesë për shkak të raporteve të cilat janë t'i përgatitur zyrtarët e drejtorive. Shuma në vlerë prej 41000 € janë mjete financiare të cilat nuk janë zotuar për shkak se ende nuk kanë filluar kërkesat e drejtorive për të cilat kemi afat deri me datë 25.11.2021 për me i zotuar që besoj që kanë me u kryer, ndërsa afati i pagesave është deri me datë 24.11.2021, shpenzime komunale mbeten mjete të lira 17345 € të cilat kemi drejtë me i zotuar deri me 12.12.2021 subvencione kemi në shumë prej 13385 € për të cilat kemi kërkesa nga qytetarët dhe nga lehonitë por në kuadër të kësaj janë edhe pagesat për rastet e vdekjes. Përveç materialit të cilin e kam përcjellë diçka të veçantë nuk kam.

Mefail Suma thekson:- a kemi obligime te projekti i shtëpisë së kulturës dhe te kompania e cila po i kryen punimet te çështja e ujësjellësit kush do t'i kryen obligimet.

Shabi Rexhallari thekson:- te projekti i shtëpisë së kulturës ende janë duke i kryer punimet dhe si obligime i kemi janë afër 290 000 € por me marrëveshjen që është arritur me Ministrinë e Kulturës afërsisht 480 000€ dhe nga kjo shumë janë 290 000 € janë obligim i punëve të cilat i ka kryer dhe mbesin afërsisht 190 000€ për me iniciuar procedurë tjetër që me i furnizuar të gjitha zyret me pajisje të cilat janë të nevojshme. Te kompania e cila është duke i kryer punimet për çështjen e ujësjellësit jemi duke e pritur alokimin e mjeteve financiare në shumë prej 40 000 € dhe pjesa tjetër është prej CDI por obligimi jonë është 158 000 ndërsa shumën prej 300000 obligim e ka me kryer CDI.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2021

4. Vendim mbi caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Shabi Rexhallari thekson:- përveç materialit të ciline keni përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sead Vila thekson:- a është dashur të organizohet dëgjim publik me bizneset për normat tatimore në mënyrë që me dhënë propozime edhe bizneset apo vetëm përmes institucioneve nga viti paraprak është vazhduar me të njëjtat norma .

Shabi Rexhallari thekson:- deri në vitin 2018 e kemi pasur rregullore për tatim në pronën e paluajtshme , mirëpo në momentin që Ministria e miratoi ligjin e ri , kuvendi i komunës nuk miraton rregullore por vendim për normat tatimore dhe raportet të cilat i ka bërë Ministria nuk mundemi mi hedh poshtë për shkak se është grup i ekspertëve që në bazë të ligjit për tatim në pronë e kanë bërë këtë dhe pas pesë viteve kemi drejtë me i dhënë vërejtjet tona me kontratë e jo paushalle.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 12 për , i kundër (z.Mefail Suma- nga grupi parlamentarë Nisma).

5. Plani i biznesit i N.P.L Pastrimi sh.a. për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sead Vila thekson:- faqe 16 shënon dy shoferë dhe nuk përputhet paga mujore me atë vjetore. Shënon që janë 25 punëtorë por zyrtari i prokurimit është përsëritur dy herë. Plani për menaxhim është deri në vitin 2021 dhe si do të vepohet tutje .

Kryesuesi thekson:- kërkoj që të analizohen dhe të përmirësohen vërejtjet të cilat u parashtruan. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për , 2 abstenim (z.Florim Shkreta dhe znj.Besarta Suma nga grupi parlamentarë i PDK-së).

U MIRATUA PLANI I PUNËS SË NPL PASTRIMI SH A PËR VITIN 2022

6. Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:-materialin e kemi përgatitur në mënyrë të detajuar dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Raporti mbi suksesin e arritur për përfundimin e vitit shkollor 2020/2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Sead Vila thekson:- në përgjithësi është menaxhuar mirë arsimi, shëndetësia dhe ekonomia që nga fillimi i pandemisë dhe kjo pandemi na ka përcjell deri para një javë sepse kemi punuar në forma të ndryshme me mbajtjen e mësimi. Ju përgëzojë dhe ju falënderojë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

8. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator 2021 i N.P.L Pastrimi sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Ilir Kaloshi thekson:- materiali është përgatitur me kohë dhe nuk kam diçka të veçantë për me shtuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

9. Kërkesa e z.Bedri Bushi për ndërrim destinim.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:-përveç materialit që është përgatit diçka të veçantë nuk kam.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA KËRKESA E BEDRI BUSHI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS

10. Propozim Vendim për lopotopët e sektorit politik dhe të punëtorëve të arsimit.

Kryesuesi thekson:-materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte 11 për , 2 abstenim (z.Florim Shkreta dhe znj.Besarta Suma nga grupi parlamentarë i PDK-së).

11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- punimet që janë bërë për ujësjellësin në rrugën e fshatit Dimcë duhet të shtrohen për shkak se e kanë prerë asfaltin . Kërkoj që të rregullohen.


Florim Shkreta thekson:- kompania e cila është duke i kryer punimet a është pajisur me leje për arsye se të paktën me paguar atë që e dëmton.

Kryesuesi thekson:-është e përcaktuar me rregullore e përcaktuar kjo çështje. A keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen. Ju falënderoj për kontributin e dhënë gjatë mandatit katër vjeçar.

Mbledhja përfundoi në ora 11:57

Procesmbajtësi

Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

MSc. Qamush Brava

